



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 82

Prishtinë, më 11 qershor 2013, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S -1

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Ardian Gjini, Gëzim Kelmendi, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivkoviq.

Munguan: Mufera Shinik dhe Arsim Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Valmir Elezi, “Top Channel”, Eral Rexha, “ RTK”, Elvis Feka, “ KTT”, Fadil Sertolli, “Zëri”, Sabit Shkodra, “ Kosova press”, Bryon Moru dhe Bajram Gecaj – UE EP, Shkëlqim H., “ KTV”, Lumturie Reka, “Kosova Info”, Mimoze Lakna, “ Bota Sot”, Besnik Ramadani- KDI, Blerta Bejtullahu - EOSK/EV Office, Eral Panduri, “ Dukagjini”, Lejla Selimi - OSBE, Armend Shkoza - LVV, Fidan Rama, “Tribuna”, Visar Smajlaj, ekspert, Sylë Ahmeti, “Kosova Sot”, Artan Canhasi- EULEX, Petrit Hysaj-OSBE, Imba Rudaku, Albulenë Gashi dhe Burbuqe Berisha, praktikantë.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi , kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të planit të zbatimit për këtë marrëveshje;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të planit të zbatimit për këtë marrëveshje;

Kryetari, dha sqarime rreth mënyrës së shqyrtimit të Projektligjit, duke shtuar se në mbledhjen e kaluar ishim dakord që këtë pikë të rendit të ditës ta shtyjme për sot, me propozimin e deputetit Gjini. Ai edhe në këtë mbledhje arsyetoi qëndrimin e tij, se pjesë e Projektligjit nuk duket të jetë plani i zbatimit.

Për këtë pikë diskutuan edhe Albulena Haxhiu, Behar Selimi, Ardian Gjini, Haki Demolli, Armend Zemaj dhe Halit Krasniqi. Diskutimet e plota janë dhënë në transkript.

Komisioni edhe në këtë mbledhje, nuk u deklarua rreth procedimit të Projektligjit dhe mbledhja radhës do të mbahet më 17.6.2013, në orën 12:00.

Mbledhja përfundoi në orën 13:55.

Kryetari i Komisionit

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Arben Gashi